



Data: 02.02.2022

SHPALLJE PËR APLIKIM

për dy (2) ekspert të jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimit në Institucionin tjetër shtetëror

Departamenti i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në pajtim me dispozitat e nenit 41 paragrafit 5 pika 5.3 të Ligjit për Zyrtar Publik dhe nenit 10 paragrafi 7 të Rregullores nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues fton të gjitha organizatat e specializuara të licencuara në Ministrinë përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale, aktualisht Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për kategorinë D dhe E, të dërgojnë ekspertët e tyre për anëtarë të mundshëm të Komisionit të Pranimit në Institucionin tjetër Shtetëror.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Eksperti i jashtëm do të jetë anëtar i Komisionit të Pranimit në kuadër të Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe do të kryej detyrat e tij, ashtu siç janë të përcaktuara në nenin 9 paragrafin 6 të Rregullores nr. 15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Kriteret e kërkuara:

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të kenë diplomë universitare të paktën 240 kredi (për edukimin e marrë jashtë vendit diploma duhet të jetë e nostrifikuar);
- Të kenë përvojë pune të paktën katër (4) vite në pozita të nivelit drejtues;
- Të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;
- Të kenë integritet moral dhe profesional;
- Të mos kenë qenë të dënuar penalisht për kryerjen e një veprë penale;
- Të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

Pagesa:

Eksperti i jashtëm paguhet me një pagesë fikse në shumën prej 250 euro e cila i paguhet ekspertit në të cilën është i angazhuar në përputhje me nenin 11 të Rregullores nr. 15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionet si më poshtë:

- CV-në;
- Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për edukimin e marrë jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;
- Kopjen e letërnjoftimit;



- Dëshmi për përvojën e punës;
- Dëshminë që nuk është i dënuar për kryerjen e një vepre penale;
- Deklaratën se nuk ka qenë anëtarë i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;
- Deklaratën se nuk është i punësuar në shërbimin civil, se nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos ketë masa disiplinore në fuqi.

Organizatrat e specializuara mund të aplikojnë përmes postës elektronike dhe dokumentet e kërkuara t'i dorëzojnë në Agjencinë hr@pak-ks.org

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta dhe inkurajojmë organizatat e specializuara që të aplikojnë me kandidatët që i plotësojnë kriteret e shpalljes.

Shpallja mbetet e hapur nga data 02/02/2022 deri më 07/02/2022 në ora 16:00.

Për informata shtesë ose sqarime mund të kontaktoni në e-mail adresën: hr@pak-ks.org